

RIGJYKIM PËR SUZANËN

ANALIZË E RASTIT



Prishtinë
Nëntor, 2020

HYRJE

Pas hulumtimit të lëndës së Suzana Zogëjani - Sekiraqa, QIKA mbështet Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Avokates Kosovare Kelmendi, me të cilën ka kërkuar që lënda të kthehet në rigjykim

Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion -QIKA është organizatë që mbron dhe promovon të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës. Përmes aktivitetit synojmë t'i bashkojmë zërat e grave dhe burrave për barazi dhe të inkurajojmë institucionet e qytetarët ta konsiderojnë barazinë gjinore si kusht të domosdoshëm për zhvillimin shoqëror.

QIKA, menjëherë pas publikimit të emisionit "Cosmo" të KTV-së lidhur me rastin e Suzana Zogëjani - Sekiraqa, ka filluar hulumtimin e këtij rasti. Për përgatitjen e këtij reagimi, ekipi i organizatës QIKA ka shqyrtuar dhe ka analizuar dokumentet e lëndës së Suzanës si në vijim:

- *Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda e datës 08.02.2019*
- *Fjala përfundimtare e mbrojtësit të Suzana Zogëjani - Sekiraqa e datës 05.12.2019*
- *Aktgjykimi PKR.37/19 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda i datës 24.01.2020*
- *Ankesa e mbrojtësit të Suzana Zogëjani-Sekiraqa e datës 12.02.2020*
- *Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, i datës 03.07.2020*
- *Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë për Gjykatën Supreme të Kosovës, e dorëzuar nga e mbrojtësja e Suzana Zogëjani - Sekiraqa më datë 18.10.2020*

Analiza e mëposhtme bazohet dhe kufizohet në shtjellimin dhe zbërthimin e këtyre dokumenteve. Nuk përjashtohet mundësia që në këtë rast të ketë edhe parregullsi dhe shkelje të tjera që mund të vërtetohen nga provat dhe dëshmitë tjera të kësaj lënde.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR FAKTIKE

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda më datë 08.02.2019 ka ngritur aktakuzë ndaj Suzana Zogëjani - Sekiraqa për vrasje të rëndë sipas nenit 179 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 të Kodit Penal të Kosovës. Më datë 24.01.2020 Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, ka nxjerrë Aktgjykim me të cilin e ka shpallur Suzana Zogëjani - Sekiraqa fajtore për vrasje të rëndë të bashkëshortit të saj sipas aktakuzës, dhe e ka dënuar me 25 vjet burgim. Pas paraqitjes së ankesës së mbrojtësit të Suzanës, Gjykata e Apelit ka nxjerrë Aktgjykim me të cilin e ka miratuar pjesërisht ankesën për sa i përket cilësimit juridik të veprës penale, mirëpo, e ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë duke e konfirmuar dënimin prej 25 vjet burgim të shqiptuar ndaj Suzanës.

GJETJET LIDHUR ME RASTIN

1.

Gjykata Themelore në Prishtinë, ia ka refuzuar Suzanës kërkesën për realizimin e ekzaminimit psikiatrik të saj dhe me këtë i ka shkelur Suzanës të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Gjykata Themelore në Prishtinë këtë refuzim të kërkesës për ekzaminimin psikiatrik të Suzanës e arsyeton duke thënë se “(...) deri më tani, nuk ka pasë para vetes asnjë provë bindëse a së paku të besueshme, se e akuzuara ka manifestuar ndonjë sjellje që do e vënte në pikëpyetje aftësinë e veprimeve të saja (...)”.[1] Më tej, Gjykata lëshohet në konstatime për gjendjen psikiatrike të Suzanës duke u bazuar në veprimet e saj pas kryerjes së krimit. Pra, Gjykata së pari ia refuzon kërkesën për ekzaminimin psikiatrik të Suzanës dhe njëherësh në Akgjykim lëshohet në konstatime për gjendjen e saj psikiatrike.

Me këtë refuzim, gjykata ka shkelur një ndër parimet themelore mbi të cilat zhvillohet procedura penale: parimin e barazisë së palëve. Sipas nenit 9 të Kodit të Procedurës Penale, prokurorja e shtetit dhe e pandehura kanë pozitë të barabartë në procedurë. Kjo do të thotë se e pandehura ka të drejtë të paraqesë prova në favor të saj dhe të thërrasë dëshmitarë apo ekspertë në emër të saj. Parimi i barazisë së palëve është element thelbësor i të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm që është e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës ku përcaktohet: “Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe **të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve** dhe të personave të tjerë, **të cilët mund të sqarojnë faktet.**”

[1] Aktgjykimi PKR.37/19 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda i datës 24.01.2020, faqe 19, paragrafi 3

Në rastin *Topic kundër Kroacisë* Gjykata Evropiane për të Drejtat e njeriut (GjEDNj) kishte konstatuar se ankuesit i ishte shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm kur gjykata kishte refuzuar kërkesën e tij për marrjen e një ekspertize që do të shkonte në favor të tij. Gjykata në Kroaci refuzimin e kishte arsyetuar duke thënë se faktet që tashmë i kishte në dispozicion ishin të mjaftueshme për vërtetimin dhe konstatimin e fakteve. GjEDNj këtë vendim e kishte konsideruar të paarsyeshëm për faktin se gjykata kroate i kishte pranuar të gjitha provat dhe dëshmitarët e prokurorisë ndërkaq, ia kishte refuzuar ankuesit mundësinë e paraqitjes së provave dhe kryerjen e ekspertizave që i kishte kërkuar. Prandaj, GjEDNj kishte konstatuar se ankuesit i ishte shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e mbrojtur sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se ankuesit i ishte mohuar e drejta e barazisë së armëve në procedurë.

Te rasti i Suzanës, arsyetimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë për refuzimin e kërkesës së Suzanës është i ngjashëm me arsyetimin e gjykatës në Kroaci. Edhe te rasti i Suzanës gjykata vendimin për refuzimin e kërkesës për ekzaminimin psikiatrik të Suzanës e ka nxjerrë duke u mbështetur në provat e paraqitura nga Prokuroria, pa ia dhënë asaj mundësinë që ta paraqesë si dëshmi ekspertizën psikiatrike që mbase do të shkonte në favor të saj. Prandaj, Gjykata Themelore në Prishtinë me refuzimin e kërkesës së saj për kryerjen e ekspertizës psikiatrike, i ka shkelur Suzanës të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës.

Qoftë edhe vetëm për këtë shkelje procedurale që ka shkaktuar shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të Suzanës, i gjithë procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj saj duhet të kthehet në rigjykim.

2.

Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese gjatë marrjes së vendimit për lartësinë e dënimit

Suzana është e mbijetuar e dhunës në familje. I ndjeri, Artan Sekiraqa kishte ushtruar dhunë fizike dhe psikike në mënyrë të përsëritur, e për vite me radhë ndaj Suzanës dhe për këtë, Gjykata Themelore në Prishtinë ka qenë e njoftuar përmes provave të paraqitura në procedurë për dhunën e përsëritur. Madje i ndjeri kishte qenë edhe në burg dhe gjykatat në Francë kishin caktuar urdhra mbrojtës për ta penguar atë t'i afrohet Suzanës dhe fëmijëve. Sipas nenit 70, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale, gjatë caktimit të dënimit gjykata merr parasysh si rrethanë lehtësuese mes tjerash: rrethanat personale të të akuzuarës, pranimin e fajit nga e akuzuara dhe keqardhjen e shfaqur nga ajo. Suzana në proces gjyqësor e kishte pranuar se e kishte vrarë Artan Sekiraqën në afekt dhe kishte shprehur keqardhje për rastin. Megjithatë, gjatë marrjes së vendimit për lartësinë e dënimit, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese.

3.

Gjykatësi ka përdorur gjuhë denigruese ndaj të akuzuarës

Një kritikë e ashpër po ashtu duhet t'i bëhet Kryetarit të Trupit Gjykses, z.Beqir Kalludra, për gjuhën e përdorur në arsyetimin e Aktgjykimit. Në faqe 19 paragrafi i parë i Aktgjykimit me të cilin është shpallur fajtores Suzana për vrasje të rëndë, theksohet: "[...]edhe Hiçkoku do ia kishte zili të njëjtës [Suzanës] për ndërtimin e një skenari të tillë imagjinar".

Gjuha e përdorur në këtë rast nga ky gjykatës është jo profesionale, paragjykuese dhe denigruese ndaj të akuzuarës. Madje, kjo pjesë e arsyetimit ngrit dyshime për atë se a është zhvilluar procedura penale në këtë rast duke e respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë ndaj të akuzuarës. Ky parim është qenësor për zhvillimin e në gjykimi të drejtë dhe të paanshëm dhe është i garantuar me Kushtetutë.

PËRFUNDIMET

Procesi gjyqësor ndaj Suzana Zogëjani – Sekiraqës është zhvilluar mbi paragjykime për fajësinë e plotë të Suzanës duke ia shkelur të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

- Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar kërkesën e Suzanës për kryerjen e ekzaminimit të saj psikiatrik, dhe këtë refuzim e ka arsyetuar duke thënë se nuk ka prova bindëse që e akuzuara ka manifestuar sjellje që do ta vinin në pikëpyetje aftësinë e saj të veprimit. Gjykata në këtë rast ia ka shkelur Suzanës të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e cila i garanton asaj të drejtën që në procedurë, në mënyrë të barabartë me Prokurorinë të paraqesë dëshmi dhe ekspertiza në favor të saj. Qoftë edhe vetëm për këtë shkelje procedurale, që njëherësh është edhe shkelje e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, do të duhej të zhvillohej një proces i ri gjyqësor.
- Gjatë marrjes së vendimit për lartësinë e dënimit, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese megjithëse gjatë procedurës gjyqësore ishin shqyrtuar prova që dëshmonin dhunën e vazhdueshme fizike dhe psikike që ia kishte shkaktuar i ndjeri Suzanës. Madje si rrethanë lehtësuese nuk ishte marrë as shprehja e keqardhjes për rastin nga Suzana dhe as pranimi i fajit për vrasjen, që sipas Suzanës ishte kryer në afekt dhe në vetmbrojtje. Këto rrethana janë dashur të merren në konsideratë nga gjykata gjatë marrjes së vendimit për lartësinë e dënimit dhe të paraqiten nga mbrojtja gjatë procesit gjyqësor.

-
- Në aktgjykim me të cilin është dënuar Suzana me 25 vjet burgim, Kryetari i Trupit Gjykses Beqir Kalludra thekson: “[...]edhe Hiçkoku do ia kishte zili të njëjtës [Suzanës] për ndërtimin e një skenari të tillë imagjinar”. Kjo gjuhë është jo-profesionale, paragjykesse dhe denigruese ndaj të akuzuarës. Madje, kjo pjesë e arsytimit ngrit dyshime për atë se a është zhvilluar procedura penale në këtë rast duke e respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë ndaj të akuzuarës. Ky parim është qenësor për zhvillimin e në gjykimi të drejtë dhe të paanshëm dhe është i garantuar me Kushtetutë.
 - Një dëshmi tjetër që tregon që rasti i Suzanës nuk është trajtuar me seriozitet e profesionalizëm është fakti se komplet faqja e tretë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit i referohet një rasti tjetër për një vepër penale për narkotikë. Lëshimet e tilla, sidomos kur ato ndodhin në raste kaq të rënda si ky i Suzanës, dëmtojnë thellë besueshmërinë ndaj gjykatës për trajtimin e veprës penale.
 - Si rrjedhojë, edhe aktgjykimi përfundimtar ka dalë si rezultat i një procesi gjyqësor i përcjellur me shkelje procedurale dhe shkelje të të drejtave fundamentale të Suzanës dhe si i tillë duhet të anulohet nga Gjykata Supreme e Kosovës ashtu që Suzanës t’i mundësohet një proces i ri dhe i drejtë gjyqësor për shqyrtimin e aktakuzës ndaj saj.